

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 31 MARS 2022

Të nderuar qytetarë,

Nuk do të përsëris shumë gjëra që u thanë lidhur me atë çfarë sjell akti normativ, por dëgjova një koleg të opozitës që sugjeroi që t'u hiqet TVSH-ja 6% të hoteleve me 4-5 yje. E para, që të sqarohet edhe publikun, bëhet fjalë për 5 ose 6 hotele me 4-5 yje, të cilët, nëse i referohemi ligjit të investimeve strategjike dhe të gjitha akteve nënligjore të nxjerra në këtë kuadër në vitin 2018, nuk janë kaq të shumtë, por janë në ndërtim e sipër dhe në investim e sipër. Megjithatë, nuk dua të bëj në asnjë moment apologjinë e investitorëve strategjikë. Me sa duket harrojmë ose bëjmë sikur harrojmë dhe kemi nevojë ta përsërisim, TVSHja 6% për strukturat akomoduese nuk është privilegj i hoteleve me 4-5 yje, është një e drejtë e caktuar në mandatin e dytë, një lehtësi fiskale e qeverisë "Rama" në mandatin e dytë për të gjitha strukturat akomoduese. E thënë me një tjetër sinonim, për të gjitha hotelet apo çfarëdolloj bujtine që ka këtë tipologji.

Prandaj, nuk ka kuptim të abuzojmë me fjalët dhe ndoshta me harresën e qëllimshme të politikave fiskale në ndihmë dhe nxitje të turizmit. Megjithatë, le t'i themi dy fjalë se çfarë do të thotë investitor strategjik dhe çfarë do të thotë investitor në hotele 4 dhe 5 yje. Janë investitorë dhe punëdhënës të mëdhenj; janë perspektivë e një stabiliteti në sektorin e turizmit për të ruajtur vendet e punës. Proven e kemi, se ishte po kjo qeveri që përballoi me sukses krizën e pandemisë, që nuk ishte një mujore apo dymujore, por gati 2-vjeçare dhe vazhdon me pasojat e saj. Ishin pikërisht investitorët e mëdhenj, që ruajtën jo thjesht vendet e punës në sistemin e hotelerisë dhe të turizmit, por edhe kualifikimin e punonjësve të tyre, sepse të gjithë e kuptojmë se çdo të thotë nëse largohen, nëse demotivohen, nëse nuk mbahen punonjësit në sektorin e turizmit dhe të hotelerisë. Nga ana tjetër, ishte po kjo qeveri, e cila tregoi se koncepti i rezistencës sociale, mua më pëlqen ta quaj i qëndresës sociale, nuk është një koncept që lindi sot, është një koncept që praktikisht e treguam në një moment shumë akut të krizës, siç ishte periudha e tërmetit.

Ishin këto hotele që strehuan ata që humbët shtëpitë prej fatkeqësisë natyrore, ishin këto struktura hotelerie, edhe të sektorit të turizmit, që përballuan edhe periudhën e vitit 2020, një periudhë e cila, në fakt, rëndoi dhe dëmtoi turizmin në të gjithë botën, por që tregoi se ishte edhe inovative, duke riorientuar tregun dhe duke treguar që nuk u rrëzuan. Kjo falë energjisë së tyre, falë lidhjes me projektet e qeverisë, falë politikave fiskale dhe solidaritetit financiar të buxhetit të shtetit. Filozofia është e njëjtë, nuk e kemi zgjedhur ne që të kalojmë nga njëra krizë në tjetrën, por ama asnjë qeveri më parë nuk ka arritur të përballojë, jo disa kriza njëra as tjetrës, por as edhe një krizë të vetme, se këtu jemi, nuk kanë kaluar 100 vjet nga përmbytjet në Ultësirën Perëndimore, pasojat e së cilës i gjetëm dhe na i latë peshqesh dhe përballuam gjithçka tjetër më pas. Edhe një gjë tjetër, e tha pak më parë kolegja Denaj, të mos harrojmë se janë 93 mijë biznese të vogla, që vazhdojnë ta kenë zero taksën. Një pjesë e madhe e strukturave hoteliere, e bizneseve në turizëm, qofshin restorante, apo bujtina, apo struktura të tjera

akomoduese janë biznese të vogla dhe jo vetëm që e kanë zero taksën, por po të kthehemi te një kosto tjetër, që rëndon mbi plan-biznesin e tyre, është çmimi i energjisë elektrike.

Sot nga buxheti i shtetit paguajmë një çmim 10 herë më të lartë në blerje dhe në importim sesa një vit më parë. Ndërkohë, të gjitha strukturat familjare dhe të gjitha bizneset e vogla vazhdojnë ta paguajnë njëlloj çmimin e energjisë, sikur të mos ishim në krizë, sepse kjo është pjesë e kësaj pakete dhe përballohet po nga buxheti i shtetit. Kjo është qëndresa sociale, kjo është rezistenca sociale për të mbrojtur shtresën shumë të rëndësishme të biznesit të vogël, ku edhe turizmi zë një vend shumë të rëndësishëm. Nga ana tjetër, nuk e kuptoj se si mund të propozoni: “Hiqni këtë takës, hiqni atë taksë!”, domethënë ka mungesë përgjegjësie deri në këtë derexhe! Kjo do të thotë ta vazhdoni fjalinë deri në fund dhe të thoni: “Lini një tokë të djegur!”, sepse kriza do të mbarojë në një moment dhe ne do të jemi sërish këtu dhe bizneset do të jenë sërish këtu. Nëse ne lëmë një tokë të djegur, si do të vazhdojë ta përballojë buxheti i shtetit dhe si do të vazhdojnë bizneset të mos e humbin filozofinë e rezistencës sociale, që më vonë duhet të jetë në rezistencë biznesi? Të mos harrojmë edhe një gjë!

Prapë do t’i kthehem pandemisë, sepse besoj se përvoja na ka mësuar se kur bëjmë ushtrime në kushte normale është shumë e thjeshtë. Kjo qeveri ka treguar se ka përballuar me sukses që prej gati 4 vjetësh tashmë, kemi hyrë në vitin e katërt, ushtrimin e riorganizimit të prioritetëve financiarë të investimeve, të përballjes së situatës së vështirë me një shpejtësi dhe me një kontakt të drejtpërdrejtë me shtesat që preken. Sigurisht, ne e dimë që nuk është e kollajtë, por nga viti 2019 e deri tani në asnjë moment nuk kemi shkuar në tokë të djegur. Në asnjë moment nuk mund t’i çojmë investimet në zero, se kur të kalojë kriza prapë do t’i rikthehem prioritetit dhe do të themi që turizmi është një degë e rëndësishme e ekonomisë. Turizëm pa investime në rrugë nuk mund të ketë, turizëm pa investime dhe pa mbështetje të bizneseve të turizmit, dhe jo vetëm të atyre që ne i quajmë hotele klasike, por edhe të diversifikimit të ofertës nuk mund të ketë. Nuk mund të kemi turizëm me tre muaj në plazh e pa e shtrirë në të gjithë sezonin. Agroturizmi vazhdon të jetë një prioritet. Kjo ka qenë arsyeja pse Ministria e Bujqësisë e ka mbështetur këtë vit agroturizmin me subvencione të dedikuara për këtë gjë. Kjo është edhe arsyeja pse me karburantet dhe me naftën që u paguhet fermerëve, mbështetet njëkohësisht një degë e ekonomisë, por po kështu edhe agroturizmit, sepse janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Të mos i mbështesim? Të heqim të gjitha subvencionet nga agroturizmi? Ministria e Kulturës vë një bonus të dedikuar për objektet e trashëgimisë kulturore për pronarët, që t’i kthejnë ato në bujtina. T’i heqim ato subvencione? Të mos i mbështesim dhe pas një viti të themi: “Kemi një gropë, sepse nuk u bënë investimet, se nuk u mbështetën agroturizmet, sepse nuk u mbështet turizmi në qendrat historike”? Rezistencë sociale nuk do të thotë zerosh një anë dhe bëj vetëm zarfe me para, por do të thotë të kesh një filozofi, me të cilën të përballosh situatën e vështirë dhe të mendosh për atë që vjen pas, përndryshe postrauma do të jetë edhe më e madhe. Përveçse dua ta përshëndes Ministrinë e Financave, që e ka sjellë këtë akt normativ në një kohë rekord, duke u përshtatur të gjitha momenteve të vështira, dua edhe të shtoj edhe një fjali të fundit. Burgu, burgu, burg! Lëruani adresën e burgut institucioneve të drejtësisë, sepse është kjo drejtësi që kjo forcë politike e ka mbështetur. Përpara se ta përmendim burgun si monedhë pa vlerë, besoj se ka ende ca akuza, të cilat nuk e kanë parë ende dritën e drejtësisë dhe ende kanë në duar gjakun e atyre 4 viktimave në protestë dhe të viktimave të Gërdecit. Këtë lërvani drejtësisë, pastaj le ta caktojë drejtësia se ku shkojnë fajtorët. Faleminderit!